

LLOGARITË FINANCIARE TË SEKTORIT FINANCIAR

DHJETOR 2017

Në publikimin e muajit Dhjetor 2017, Departamenti i Statistikave Financiare për herë të parë, ofron për publikun statistikën e *Llogarive financiare të sektorit të korporatave financiare* dhe *Listën e njësive institucionale të klasifikuara në sektorin financiar*.

Kjo statistikë është pjesë e një blloku të rëndësishëm statistikor, atë të *Llogarive Financiare*¹, të cilat përfshijnë sektorizimin e plotë institucional, në: *korporata financiare, korporatat jofinanciare, qeveria e përgjithshme, ekonomitë familjare, institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare dhe jorezidentët*.

Si një pjesë e pavarur e *Llogarive kombëtare*, llogaritë financiare ofrojnë një pamje të plotë, gjithpërfshirëse të situatës financiare dhe marrëdhënieve financiare në ekonomi, përsa i përket sektorëve ekonomikë dhe instrumenteve financiarë, përfshirë dhe marrëdhëniet me jorezidentët. Ato ofrojnë një tablo mbi operacionet dhe strukturën e sistemit financiar dhe tregojnë kanalet kryesore të përdorura për të përfutur dhe investuar burimet financiare.

Kjo statistikë, është një burim i rëndësishëm informacioni për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar. Nga pikëpamja e politikës monetare, llogaritë financiare tregojnë burimin e financimit të sektorëve ekonomikë, duke dhënë një informacion të shtuar mbi strukturën e ekonomisë dhe ekspozimin e sektorit të brendshëm ndaj atij jorezident. Gjithashtu, kjo statistikë jep informacion mbi instrumentet e financimit, psh. nëse një sektor financohet me kredi bankare apo me instrumente të tjera. Lloji i instrumentit është i rëndësishëm për të përcaktuar zgjerimin e masës monetare në ekonomi. Nga pikëpamja e stabilitetit financiar, llogaritë

financiare analizohen si një rrjet ekspozimesh të ndërlidhura, edhe pse përkufizimet për vlerësimin dhe konceptet janë më shumë makro-ekonomike sesa të orientuara drejt rrezikut. Megjithatë ndërlidhjet sektoriale mund të ndihmojë për të zbuluar mekanizma të transmetimit të rrezikut. Në këtë kontekst, analiza e këtij rrjeti mund të zbulojnë që edhe pse një pjesë e sistemit financiar që konsiderohet veçanërisht i qendrueshëm ndaj një skenar të caktuar negativ ende mund të ndikohet për shkak të ndërlidhjes së tij të ngushtë me sektorët që janë konfrontuar direkt nga ngjarje të paparashikuara.

Tabelat bashkëlidhur këtij njoftimi, paraqesin të detajuara llogaritë financiare për *nënsektorët e korporatave financiare*, të tillë si: Banka qendrore (S.121), Korporatat e tjera depozituese (S.122), Fondet e investimit (jo të tregut të parasë) (S.124), Ndërmjetës të tjerë financiarë (përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit) dhe Ndhimësit financiarë (S.125+S.126+S.127) dhe Kompanitë e sigurimit dhe Fondet e pensionit (S.128+S.129).

Këto statistika do t'u ofrohen përdoruesve në seri kohore që prej dhjetorit 2012, në periodicitet vjetor.

METODOLOGJIA

Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare (ESA 2010 është koncepti kryesor për përkufizimin dhe disagregimin e instrumenteve financiare dhe sektorëve të ekonomisë.

Manuali ESA 2010 është një standard ndërkombëtar që shërben për hartimin e statistikave të llogarive financiare, për të gjitha vendet në Evropë. Pajtueshmëria me standardet, përkufizimet, rregullat e kontabilitetit dhe klasifikimet sigurojnë konsistencë me sistemin e përgjithshëm të llogarive kombëtare, si dhe krahasueshmërinë e tyre në nivel ndërkombëtar. Struktura e ESA 2010 është në përputhje me parimet e vlefshme globalisht të kontabilitetit kombëtar të përcaktuara në SNA 2008 (Sistemin e Llogarive Kombëtare). Ajo është e harmonizuar më tej me statistikat kryesore sociale dhe ekonomike.

¹ Llogaritë financiare në paraqitje të plotë (të gjithë sektorët institucionale) do të publikohen në fund të vitit 2018, sikundër parashikohet në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe në Kalendarin e Publikimit të statistikave të Bankës së Shqipërisë. https://www.bankofalbania.org/previewdoc.php?file_id=10036.

MBULIMI INSTITUTIONAL

Hartimi i listës së njësive institucionale të klasifikuara në sektorin financiar, përbën një hallkë të rëndësishme në hartimin me cilësi të kësaj statistike. Procesi i klasifikimit të institucioneve është diskutuar, gjithashtu, në grupin e punës ndërinstitucional (Instat dhe MF) si dhe me ekspertë të huaj nga EUROSTAT dhe FMN.

Lista bashkëlidhur këtij njoftimi, i referohet të dhënave më të fundit të disponuar në Nëntor 2017. Ky klasifikim do të jetë subjekt i revizionimeve vjetore².

BURIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat merren në mënyrë direkte nga institucionet raportuese si burim primar, ose në mënyrë indirekte nga informacioni kundërparti. Për mbledhjen e të dhënave primare, statistikat e llogarive financiare përdorin gjerësisht të dhënat e mbledhura nga Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit të unifikuar të raportimit (ERRS) dhe raportime të tjera pranë Bankës së Shqipërisë, ndërkohë që burime suplementare përdoren për të plotësuar mangësitë në burimet primare ose për të përmirësuar cilësinë e statistikave. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë bashkëpunon ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në maksimizimin e përdorimit të të dhënave administrative.

KLASIFIKIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE.

Klasifikimi i instrumenteve financiare bazohet kryesisht në shkallën e likuiditetit dhe në karakteristikat e tyre. Aktivet financiare, të cilat gjenerojnë të ardhura kanë kundërpartinë e tyre homologe të detyrimeve në sektorë të tjerë institucionalë. Prandaj, në të dy anët e llogarive paraqiten të njëjtat instrumente financiare:

- *Ari monetar dhe SDR (AF.1)*

- *Monedha dhe depozitat (AF.2),*
- *Letrat me vlerë të borxhit (AF.3),*
- *Huatë (AF.4),*
- *Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit (AF.5),*
- *Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor (AF.6),*
- *Derivatitë financiarë (AF.7)*
- *Llogari të tjera të arkëtueshme/pagueshme (AF.8).*

Tabela 1: Burimet kryesore të informacionit për përpilimin e llogarive financiare të sektorit financiar.

Sektorët dhe nënsektorët	Burimi informacioni t/ Numri i njësive institucionale	Afati i raportimit	
Korporatat financiare (S12)			
Banka qendrore (S.121)	BSh/1	10 ditë pas muajit referencë	
Korporatat e tjera depozituese (S.122)	Bankat e nivelit të dytë	BSh/16	30 ditë pas muajit referencë
	Shoqëritë e kursim kreditit	BSh/13	50 ditë pas tremujorit referencë
Fondet e investimit (S.124)	AMF/3	90 ditë pas tremujorit referencë	
Ndërmjetës të tjerë financiarë dhe Ndihmësit financiarë (S.125+S.126+S.127)	Ndërmjetës të tjerë financiarë, (S.125)	BSh/16	40 ditë pas tremujorit referencë
	Ndihmësit financiarë (S.126)	BSh, AMF, QKB/105	40 dhe 90 ditë pas tremujorit referencë
	Kompanitë e financimit të kontrolluara nga komp. të tjera S.127)	BSh/1	40 ditë pas tremujorit referencë
Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve (S.128+S.129)	Kompanitë e sigurimit (S.128)	AMF/11	90 ditë pas tremujorit referencë
	Fondet e pensioneve (S.129)	AMF/3	90 ditë pas tremujorit referencë

Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

²Lista e detajuar e njësive institucionale të klasifikuara në sektorin financiar shqiptar gjendet online në adresën <https://www.bankofalbania.org/statistika/publikime>